



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.05- 281
Podujevë,
28.08.2024

FTESË PËR OFERTË (EKSKURSION)

Bazuar në Ligjin për transportin rrugor nr. 04/L – 179 neni 28, UA 06/2015 të MI për lëshimin e lejeve për kryerjen e transportit të rregullt ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve, qasje dhe kalim transit nëpër territorin e Kosovës, UA (MASHT) për aktivitetet jashtëshkollore 02/2016, të datës 12.01.2016, neni 11, MASHT dhe kërkesave të shkollave të mesme të larta të listuara më poshtë, ftojmë agjencitë turistike që të konkurrojnë për organizimin e ekskursionit për maturanët e Komunës së Podujevës, në Republikën e Shqipërisë, për shkollat:

- Gjimnazi " Aleksandër Xhuvani " -Podujevë
- IAAP " Fan S. Noli " -Podujevë
- IAAP " Isa Boletini " -Podujevë

Ekskursioni organizohet për 4 (katër) bujtje dhe 5 (pesë) ditë kalendarike .

Ofertuesi (agjencioni turistike) duhet t'i plotësojë këto parakushte

1. Të jetë i licencuar,
2. Të ketë bërë kontrollimin teknik sipas procedurave ligjore,
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës,
4. Autobusët të jenë komform dhe të kenë klimë,
5. Të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusëve
6. Të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut), si dhe të

paraqesë këto dokumente :

1. Licencën nga Ministria e Postë-Telekomunikacionit, me licencë B, D
2. Gjendjen teknike të autobusëve brenda 6 muajsh ,
3. Çmimet e plota të pansioneve,
4. Menynë e ushqimit ditor,
5. Imazhin e agjencisë - referenca për organizime të ekskursioneve me nxënës të shkollave të mesme të komunës së Podujevës (ku edhe ofertojnë si dhe kontrata me hotele – konfirmimi nga hoteli)
6. Dokumentacionin plotësues (kontratë me mjekun e mjekësisë familjare)
7. Të ketë dokumentacionin – licencën e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve

Aplikuesit duhet të aplikojnë për secilën shkollë individualisht.

Dokumentacioni dorëzohet në Drejtorinë e Arsimit, deri më 04.09.2024, në orën 13.30.

Hapja e ofertave bëhet më 04.09.2024, në orën 14.00.

drejtori
Avni Fetahu

